

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kanë kaluar tashme 8 vjet e tre muaj nga koha kur Kuvendi i Shqipërisë miratoi amendamentet kushtetuese të Reformës në Drejtësi. Sipas dokumentave parlamentare, Misioni i Reformes ishte siguri i një sistemi gjyqësor **efektiv, efikas, të pavarur dhe transparent**, në përputhje me praktikën më të mira evropiane.

**Efektiviteti dhe Efikasiteti** perkthehen si një shërbim gjyqësor i shpejtë dhe cilësor ndaj publikut. Eliminimi i zvarritjeve gjyqësore është sinonim i efikasitetit. Vlerësimi i vonesave gjyqësore është rrjedhimisht një tregues i realizimit të vetë misionit të Reformës, në të paktën dy nga katër komponentët përbërës të tij.

Kushtetuta e Shqipërisë përcakton se “*Kujtdo i garantohet e një gjykim i drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm*” (neni 42, par. 2)”. Edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut në nenin 6 të saj përcakton se: “*Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm...*”.

*Për t'u përfruar me mire me garancitë e Kushtetutes dhe të Konventes, Kuvendi miratoi afatet prekluzive për gjykimin e arsyeshëm në nenin 399/2 të K.Pr.C, i ndryshuar në vitin 2017 në kuadër të Reformës në Drejtësi. INFOÇIP e ka advokuar këtë proces që në fillësë, dhe ka përfaqësuar interesin e publikut për eliminimin e zvarritjeve gjyqësore.*

Për fat të keq, vonesat janë rritur në nivele të pa-vëzhguara më parë, sidomos në apel. Edhe stoku është rritur në nivele që caktojnë rekorde historike. Numri i gjyqtarëve në apel vijon të mbetet në nivelet më të ulëta historike gjithashtu. Pasojë direkte e kësaj situatë, janë numri i madh i ankimeve që po tejkalojnë afatet e gjykimit të arsyeshëm. Në vitin 2016 vetëm 1 % e çështjeve civile të themelit tejkalonin afatin 2-vjeçar në shqyrtim; në gjashtëmujorin e parë të 2023, 78% kanë marrë vendim tej afatit të gjykimit të arsyeshëm 2-vjeçar. **Situata duhet të konsiderohet një emergjence kombëtare, pasi rrezikohet një shkelje masive e të drejtave të njeriut.**

Në 12 tetor 2021, GJEDNJ dënoi shtetin shqiptar me 3500 Euro, plus shpenzimet gjyqësore për vonesat e shkaktuara në shqyrtimin gjyqësor ndaj dy shtetasve të saj (*Çështja Barra dhe Kola Vs. Albania*<sup>1</sup>).

Fenomeni i ankimeve për vonesa gjyqësore tej afatit të arsyeshëm po gjen zgjerim. Bazuar në vëzhgimet empirike të INFOÇIP, numri i ankimeve në Gjakatën e Lartë është në rritje konstante, kurse aplikimet në Gjakatën Kushtetuese kanë arritur një rekord historik prej 500 ankimesh, nga rreth 50 që arrinin dikur për këtë objekt. Avokatët pohojnë se destinacioni final i këtyre ankimeve është Strasburgu.

<sup>1</sup> z. Petrit Bara (“kërkuesi i parë”) dhe z. Eduard Kola (“kërkuesi i dytë”). Me gjithë shpenzimet gjyqësore, penaliteti që duhet të paguajë Shqipëria ndaj dy qyterarëve të saj për vonesa në shqyrtimin gjyqësor tej afatit të arsyeshëm shkon gjithsej në 5900 Euro.

**Pavarësisht precedentit “Barra dhe Kola kundër Shqipërisë”, vetë gjykatat shqiptare barrën e vonesave ja kanë shkarkuar deri tani në kurriz qytetarëve.** Praktika gjyqësore e deritanishme sa i takon tejkalimit të afatit të gjykimit të arsyeshem në apel është tërësisht dekurajuese nga GJ. Larte. Por, **Drejtësia e vonuar është Drejtësi e mohuar !** Cilatdo qofshin arsytet, përfshi këtu edhe shkaqet objektive që lidhen me vetingun, INFOÇIP qëndron fort pro këtij postulati që përcakton vetë thelbin e drejtësisë efektive.

Interesi publik për një drejtësi pa vonesa, sa kohë është një garanci kushtetuese dhe çështje e të dretave të njeriut, duhet të peshojë më shumë në peshoren e drejtësisë vendase sa sa çështjet e përkohshme me natyrë administrative. Përveç vendimeve të Strasburgut në këtë drejtim, edhe vendimet e Gjykatës sonë Kushtetuese, por mbi të gjitha parashikimet e vetë ligjit procedural të miratuar në kuadër të Reformës në Drejtësi sa i takon dekurajimit të vonesave gjyqësore duhet të gjejnë zbatim sa më parë.

Me mbështetjen e Ambasadës Holandeze, në kuadër të Programit MATRA, INFOÇIP aktivizoi në vitin 2022 monitorimin e kohëzgjatjes gjyqësore në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm. Ky program u ndërpre në vitin 2020, për shkak të pandemisë. Ri-aktivizim është i rëndësishëm pasi:

- *Ndërlidh treguesit e periudhës 2020-2023<sup>2</sup> me periudhën 2016-2019 për të gjitha gjykatat e apelit në RSH (juridiksioni i përgjithshëm), cka mundeson krahasimin objektiv të treguesve të kohëzgjatjes gjyqësore që nga fillimi i Reformës në Drejtësi 8 vjet më parë e deri më sot.*
- *Për herë të parë identifikon çështjet gjyqësore që dolën jashtë afateve të gjykimit të arsyeshëm në apel*
- *Për herë të parë vlereson dhe krahason treguesit e kohëzgjatjes gjyqësore pas Reformës së Rretheve Gjyqësore<sup>3</sup>, koncretisht 6 mujorin 1 Shkurt-31 Korrik 2023.*
- *Për herë të parë vlerëson afatet ligjore të shqyrtimit dhe arsyetimit për masat e sigurimit dhe urdhrat e mbrojtjes në apel për periudhën 4-vjecare 2020-2023,*

Te dhenat janë informatizuar në Platfomën [www.gjykataehapur.al](http://www.gjykataehapur.al) e cila është e hapur për të gjithë të interesuarit dhe lejon verifikimin e pavarur të gjetjeve. INFOÇIP ka ndërvepruar me KLGJ dhe stafet e gjykatave për të promovuar transparencën e gjykatave. Gjetjet synojnë të sensibilizojë KLGJ, ILD, Kuvendin dhe Qeverinë lidhur me rrezikun potencial që përfaqësojnë vonesat e shtuara gjyqësore ndaj besueshmërisë së reformave, financave publike dhe mbi të gjitha ndaj interesit legjitim të qytetarëve për të marrë në drejtësi në kohë dhe me cilësi nga gjykatat.

<sup>2</sup> Monitoruesit e INFOÇIP mbojnë të dhëna gjyqësore për periudhën 2020-2023, në të gjitha gjykatat e apelit, me përjashtim të Gj. Aplelit Gjirokastër, për shkak të rrethanave specifike.

<sup>3</sup> Në kuadër të Reformës së re të Rretheve Gjyqësore, Gjykatat e Apelit (6 gjithsej) u shkrinë në datë 1 Shkurt 2023 në një gjykatë të vetme apeli të juridiksionit të përgjithshëm, e vendosur në Tiranë.

## DY FJALE PER GJETJET KRYESORE

Vlerësimi tematik ka analizuar 4 tipologji vendimarrëse në apel: gjykimet e themelit -penale dhe civile, masat e sigurimit, urdhrat e mbrojtjes. Në terma të përgjithshëm, konstatohet:

- **Përkeqesim i ndjeshëm** i kohëzgjatjes gjyqësore për gjykimet e themelit në apel nga viti 2016 deri në 6 muajori e parë 2023.
- **Normalitet** sa i takon shqyrtimt brenda afatit ligjor të masave të sigurimit, por një përkeqesim i ndjeshëm sa i takon arsyetimit të ketyre vendimeve brenda afatit ligjor 10-ditor (periudha 2020-2023)
- **Shkelje domethënëse** sa i takon respektimit të afatit 15 ditor të shqyrtimit të urdhrave të mbrojtjes (periudha 2020-2023)
- **Emergjence** sa i takon Stokut Gjyqësor në Apel, Studimi del në përfundimin se ai është me trend konstant rritës dhe bart potencialin të shkaktojë shkelje masive të drejtave të njeriut sa i takon një procesi gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm.

### *Ne terma konkrete:*

**Kohëzgjatja e shqyrtimit gjyqësor ne apel për çështjet e themelit, penale ashtu dhe civile ka pësuar përkeqesim te ndjeshem. Krahasuar me vitin 2016 kur nisi Reforma ne drejtesi, kohezgjatja mesatare** u dyfishua e madje duke u trefishuar. Ankimet e themelit perfaqesojne rreth gjysmen e volumit vendimarrës ne apel. Gjithmone e me pak gjykata arrin te marre ne shqyrtim sot ceshtje te tilla; ato jane kontributorët kryesore ne stokun e akumuluar.

Ne vitin 2016, një çështje civile themeli ne Gjykatën e Apelit Tirane zgjidhej mesatarish per 377 dite, në 2022 ajo shkoi 1118 dite. Në GJ. A. Durrës zgjidhej per 361 ditë ne 2016, në 2022 shkoi 677 ditë. Në GJ.A Vlorë nga 346 shkoi në 1084 ditë; ne GJ. A Shkodër, nga 325 shkoi në 603 ditë dhe në GJA Korçë nga 147 shkoi në 533 dite mesatarist për periudhën e krahasuar 2016-2022.

Referuar **6-mujorit të parë 2023** (1 Shkurt-31 Korrik), kohëzgjatja mesatare për shqyrtimin e çështjeve civile të themelit ka qenë 646 ditë, kurse për çështjet penale të themelit ka qenë 547 ditë. Çështjet më të vonuara që morën vendim në 2023-in janë në rangun e 2900 ditëve nga regjistrimi i ankimit në apel, ose rreth 7 vjet.

Treguesit pritet të përkeqësohet në muajt në vijim pasi Backlogu arriti në Tetor 2023 shifrën rekord prej 37 mijë dosjesh në këtë gjykatë. Ndërkohë, nga 78 gjyqtarë që janë të miratuar në organikë, kjo gjykatë nisi punën me vetëm 24, dhe kjo shifër ka qenë me tendencë uljeje të mëtejshme.

\*\*\*

**Sa i takon afatit të gjykimit të arsyeshëm në Apel**, rezulton një përkeqesim i ndjeshëm, që rëndon posaçërisht mbi gjykimet çështjeve të themelit. Në vitin 2016, në të gjitha gjykatat e apelit të marra së bashku, jashtë afatit të arsyeshëm nuk dilnin as 1% e totalit të çështjeve civile të themelit (57 nga 6470 vendime te dhena gjithsej) . Ndërkohë, në

vitin 2022, jashtë këtij afati sensitiv për të drejtat e njeriut dolën 54% e totalit (940 nga 1729 vendime të dhena gjithsej). **Në 6-mujorin e parë 2023, jashtë afatit të gjykimit të arsyeshëm dolën 78% e gjykimeve civile të themelit.**

Lidhur me gjykimet për çështje PENALE themeli, në vitin 2016 jashtë afatit të arsyeshëm dilnin rreth 27% e totalit të dosjeve të shqyrtuara (1241 nga 4569 çështje që moren vendim). Në periudhën 1 Shkurt-31 Korrik 2023, (6-mujori i parë i punës së GJAJP Tiranë), jashtë afatit të arsyeshëm dolën 44% e totalit të çështjeve penale të themelit (599 nga 1346 në 6-mujorin e parë të punës).

Në total, janë evidentuar 14126 shqyrtime themeli në apel që kanë marrë vendim në tejkalim të afateve të arsyeshme në periudhën 2016-2023. Sikur vetëm gjysma e tyre të shqyrtoheshin me standartin e GJEDNJ në çështjen Barra dhe Kola kundër Shqipërisë, kostot e reformës në drejtësi do fryheshin me 35 milion Euro. Do të ishte e padrejtë nëse përveç vonesave, qytetarët të duhet të paguanin tashme si taksapagues edhe kostot oportune që mund të vijnë si pasojë e ankimimeve për vonesa gjyqësore përmes denimit eventual të shteteit shqiptar.

\*\*\*

**Për herë të parë INFOÇIP ka vlerësuar dhe afatet ligjore të shqyrtimit dhe arsyetimit të masave të sigurimit në apel. Kjo kategori zë volumnin e dytë më të madh të gjykimeve në apel pas themeleve.**

Kohëzgjatja mesatare për shqyrtimin masave të sigurimit nuk e kapërceu afatin ligjor 10-ditor për 3-vjecarin 2020-2022.

INFOCIP analizoi edhe 1000 vendime masa sigurimi të dhëna në periudhën 1 Shkurt-4 Korrik 2023 nga GJAJP Tiranë. Për herë të konstatohet se mesatarja kapërceu pragun pragun ligjor duke u ngjitur në 10.5 ditë. Nga 1000 raste të analizuara, në 88 prej tyre vendimet janë marrë tej afatit ligjor 10-ditor të shqyrtimit. Në këtë kuptim, treguesit shfaqin tendence përkeqësimi pas Reformës së Rretheve Gjyqësore, edhe pse ndryshimet procedurale lejojnë gjykimin me vetëm një gjyqtar për ankimet ndaj masave të sigurimit. Problemi i identifikuar nga INFOCIP në këtë rast ka të bëjë me infrastrukturën materiale; pasi ka tre salla në dispozicion për 12 gjyqtarë që aktualisht Dhoma Penale e GJAJP; teksa tre gjykojnë, 9 të tjerë duhet të presin lirimin e sallave.

Problem serioz mbeten afatet e arsyetimit të vendimit për masë sigurimi. Ky tregues, i mesatarizuar ka tejkaluar me gati 3fish afatin që cakton ligji procedural në periudhën matur 2020-2022. Në periudhën 1 Shkurt-4 Korrik 2023 mesatarja në dorëzim rezultoi 34.1 ditë në GJAJP Tiranë. **Nga 1000 raste të analizuara, 755 vendime (75.5% e totalit) janë arsyetuar/dorëzuar tej afatit ligjor. Ky konsiderohet një tregues shumë problematik.**

\*\*\*

**Urdhrat e mbrojtjes në apel** analizohen gjithashtu për herë të pare, për periudhën 2020-2023. Sipas Ligjit 9669/2006 Gjykata e Apelit shprehet me vendim brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të ankimit ndaj urdhrimit të mbrojtjes.

Pavarësisht se ankimet në apel për urdhrat e mbrojtjes përfaqësojnë një volum relativisht të vogël çështjesh, kohëzgjatja mesatare në shqyrtim për periudhën 2020-2022 e tejkaloi afatin ligjor 15-ditor në të gjitha rastet e analizuara. Në 6–mujorin e parë të punës së GJAJP Tiranë, mesatarja e shqyrtimit të urdhrave të mbrojtjes në Apel rezultoi 31.7 ditë, mesatarja e dorëzimit 51 ditë, ndërsa totali i vendimeve të nxjerra jashtë afatit ligjor rezulton 62% e totalit (113 vendime gjithsej në regjister).

\*\*\*

### **Reforma e Rretheve Gjyqësore, stoku dhe trupa gjyqësore në Apel**

Që prej 1 Shkurtit 2023, 6 gjykata apeli u shkrinë në një gjykatë të vetme me seli në Tiranë, në kuadër të Reformës së Rretheve Gjyqësore. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë nisi punë me vetëm 24 gjyqtarë, nga 78 të miratuar në organikë. Në shtator 2023 trupa numëronte 22 gjyqtarë.

Sipas KLGJ, të 6 gjykatat e apelit para se të shkriheshin në një të vetme, bartën një stok prej 31370 çështjesh. Sipas të dhënave të mbledhura nga INFOÇIP në GJAJP Tiranë, deri në shtator 2023, stoku i çështjeve, së bashku me prurjet e reja, arriti në 36 mijë dosje. Nga informacioni i përditësuar në 11 Tetor 2023, stoku në GJAJP Tiranë arriti në 37 mijë dosje. Projektioni për stokun deri në dhjetor 2023 është më e pakta 38000 ankime.

Nëse një trupë prej vetëm 25 gjyqtarësh do të punonte për të evaduar stokun aktual prej 37000 dosjesh, me një mesatare prej 300 vendimesh në vit për gjyqtar (*çdo ditë një gjyq fillim-mbarim pasuar nga vendim*), do të nevojiteshin rreth 5 vite vetëm për të evakuuar stokun, pa marrë në shqyrtim asnjë ankim të ri që do të vinte.

Nëse trupa do të ishte e përbërë nga 78 gjyqtarë, atëherë, ky stok do të evadohej për 1.5 vjet, perlllogaritur me normen 300 vendime ne vit/gjyqtar. Për t'u përafuar me treguesit e para-Reformës (viti 2016), numri i gjyqtarëve në GJAJP Tiranë do duhet të ishte të paktën 100 (koha e evadimit vetëm për stokun aktual: 1.2 vjet).

**Mungesa e gjyqtarëve vlerësohet nga ky studim si shkaku kryesor i vonesave gjyqësore në rritje.** Ndryshimi i disa rregullave procedurale në administrimin e procesit gjyqësor mund të ketë patur një impakt pozitiv, sidomos sa i takon shqyrtimit me te shpejte te masave te sigurimit. Mjediset e pamjaftueshme gjithashtu po ulin efektivitetin gjyqësor. **Reforma e Rretheve Gjyqësore rrezikon të mos prodhojë objektivat e synuar në terma të aksesit në një shërbim gjyqësor pa vonesa nëse nuk adresohet me urgjencë shtimi i trupës gjyqësore.**

Shoqeria civile ka një rol aktiv për të luajtur, në mbështetje të intitucioneve të drejtësisë në adresimin e situatave të krijuara, duke i qendruar besnike mbi të gjitha interesit legjitim të qytetareve për një drejtësi pa vonesa.